

20595
24.12.15



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. (31004-06923-86-2015)12908 Rregj. Them
Data Regjistrimi 16.11.2015

Nr. 2663(86-2015-495 Vendimi
Datë 10.12.2015

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTAR - Altina NASUFI
GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot me datë 10.12.2015, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

PADITËS: Shoqëria "Pacili" sh.p.k, adrresa: rruga Kapshtic-Korçë.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

OBJEKTI: Shfuqizimin tërësisht të Aktit Administrativ, "Njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor" nr 5653 prot date 17.11.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, si nje akt administrativ relativisht i pavlefshëm dhe anulimin e gjobës me vlerë 500 000 lekë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës neni, 109/2 dhe 123 i ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, udhezimi nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" , VKM nr.781 datë 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike dhe funksionale të paisjeve fiskale" nenet 7/a,11/1,15/a,16 pika 1 dhe 17 pika l/a) i ligjit nr.49/2012, neni 115/b) dhe 118 i K.Pr.Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. 470, datë 30.09.2015 ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të padisë .
2. Shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ, "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr 5653 prot, datë 14.11.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë", lidhur me masen e detyrimit tatimor (gjobë) në shumën 400 000 lekë dhe lënien në fuqi për diferencën e gjobës prej 100 000 lekë.
3. Shpenzimet gjyqësore të taksës mbi aktet në shumën 3 000 lekë, i ngarkohen palës së paditur në masën 2500 lekë dhe 500 lekë mbeten në ngarkim të paditësit.

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Korçë duke parashtruar shkaqet për ndryshimin pjesërisht të vendimit 470, datë 30.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, si më poshtë vijon;

1. Gjykata ka vlerësuar drejtë kur ka konstatuar kryerjen e kundravajtjes administrative nga ana e palës paditëse sipas nenit 122 të ligjit nr.9920, por gjykata ka keq interpretuar ligjin e posaçëm dhe gjëndjen e faktit të konstatuar në lidhje me aplikimin e masës së dënimit.
2. Në rastin në gjykim paditësi është penalizuar sipas përcaktimit të neni 122, pika 1, gërma a) nëndarja ii, pasi më parë ka konsumuar kundravajtje administrative dhe ka kryer pagesën e saj në masën 100,000 lekë.
3. Gjykata në arsyetimin e saj shprehet se nuk ka një konstatim të mëparshëm ku kundravajtësit ti jetë lënë afat vendosje dhe ai të mos e ketë zbatuar.
4. Në referim të ligjit për Kundravajtjet Administrative neni 4 të ligjit 10279 datë 20.05.2010 kundravajtja administrative përkufizohet *“shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore të kryera me veprime apo mosveprime dhe për të cilat ligji parashiokon dënime administrative”*.
5. Për sa kohë ligji ka parashikuar kryerjen e kundravajtjes administrative me veprime apo mosveprime të subjektit, me të drejtë organi tatimor ka aplikuar masën e gjobës 500.000 lekë, pas konstatimit të parë të shkeljes për të cilën është vendosur masa e gjobës 100,000 lekë.
6. Gjykata ka keqinterpretuar afatin 10 ditor të cituar në nenin 122 të ligjit për procedurat tatimore. Afati i parashikuar në nëndarjen i të gërmës a) të ligjit është për tatimpaguesit e regjistruar rishtazi dhe pajisjen e tyre me kasa fiskale. Ndërsa pika e dytë ka të bëjë me afatin 10 ditor, pasi është vendosur masa e parë e gjobës në vlerën 100.000 lek.
7. Gjykata në arsyetimin e saj e lidh kryerjen e kundravajtjes në lidhje me vendin ku kryhet dhe jo me veprimet apo mosveprimet e kryera nga tatimpaguesi në shkelje të ligjit.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi dëgjoi palët ndërgjyqëse, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankimet e paraqitura, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse shoqëria “Pacili” sh.p.k, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimin tërësisht të Aktit Administrativ, “Njoftim vlerësimi për detyrimin tatimor” nr 653 prot date 17.11.2014 të Drejtorise Rajonale Tatimore Korçë, si nje akt administrativ relativisht i pavlefshëm dhe anulimin e gjobës me vlerë 500 000 leke.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime i ka referuar si bazë ligjore Neni 42 i Kushtetutës neni, 109/2 dhe 123 i ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, udhezimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” , VKM nr.781 datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike dhe funksionale të paisjeve fiskale” nenet 7/a,11/1,15/a,16 pika 1 dhe 17 pika l/a) i ligjit nr.49/2012, neni 115/b) dhe 118 i K.Pr.Administrative

Gjykata e Administrative e Shkallës së Parë Korçë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes me vendimin nr.470, datë 30.09.2015, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së shoqërisë “Paceli” sh.p.k, sipas përcaktimit në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Drejtoria Rajonale Tatimor Korçë, për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Konstatohet se ankimi i paraqitur nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë është dorëzuar në datën 14.10.2015, brënda afateve të parashikuara nga ligji dhe është përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tyre, e për rrjedhojë është shoqëruar me vendimin e gjyqtarit nr.384, datë 16.10.2015, që ka pranuar ankimet. Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet ankimit të palës paditëse në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes të përcjella me ankimin, rezulton se:

Shoqëria paditëse "PACILI" është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pranë Qendrës Kombëtare të rregjistrimit në datën 01.07.1996 me objekt te veprimtarisë "Import, tregëti me shumicë e pakicë të karburanteve dhe derivateve të tyre. Prodhim dhe tregëtim dyer, dritare e vetrata duralumini dhe palstike. Import, eksport me shumicë apo me pakicë i të gjitha materialeve që i nevojiten kësaj shoqërie etj".

Në datën 24.08.2014 pranë subjektit "PACILI" në adresën e veprimtarisë Rruga Koshticë-Korçë, rezulton se është ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorisë së Hetimit Tatimor dhe sipas "Akt konstatimit" datë 24.08.2014 është evidentuar ndër të tjera se "subjekti ka një distributor gazi të lenget me një pistolette e cila nuk është e vulosur dhe nuk është e lidhur me kasën fiskale".

Bazuar mbi të dhënat e mësipërme nga Inspektoret e Drejtorisë Rajonale Korçë (DRT) është mbajtur "Procesverbali i gjobes" date 11.11.2014 ku subjekti është dënuar me gjobë në shumën 500 000 leke, bazuar në nenin 122, pika 1, germa a) nëndarja ii) e ligjit 9920 datë 19.05.2008, pasi tregëton gaz të lëngshëm me pistolette të papajisur me kasë fiskale.

Në vijim DRT Korçë me shkresën nr. 5653 Prot në datën 17.11.2014 ka nxjerë "Njoftim vleresimin për detyrimet tatimore" për pagesën e detyrimit gjobë në shumën 500 000 leke "Për mospajisje me kasë fiskale".

Meqenese shoqëria nuk ka qënë dakord me detyrimet tatimore sipas "Njoftim vleresimit", pasi është vënë në dijeni të tij e ka ankimuar "Njoftim-vlerësimin" në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila me vendim nr 1716/ 1 Prot datë 23.03.2015 "ka refuzuar ankimin me aresyetimin se është dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara me ligj".

Në aktet e dosjes është e depozituar në cilësinë e provës shkresa nr 495 prot date 22.07.2015 "Kthim përgjigje" e Filialit të Postës Korçë në të cilën konfirmohet se: "...në lidhje me dorëzimin e objektit nr 5653 prot datë 14.11.2014 nga DRT Korçë në adresë të Shoqërisë "Pacili" sh.p.k, ju informojmë se ky objekt ka ndjekur rrugën zyrtare sipas rregullores së shërbimit postar. Është pranuar në Zyrën Qëndror Korçë dhe më pas është vijuar në Zyrën Postare Bilisht tek e cila i është dhënë për shpërndarje punonjësit të kësaj zyre Nuri Mullaj, i cili deklaroi se objekti i ka humbur dhe nuk i është dorëzuar personit të cilit i është adresuar. Për këtë punonjës nga Drejtoria i Filialit të postës u morr masa administrative".

Në këto kushte paditësi shoqëria Pacili sh.p.k duke mos qënë dakort me veprimet e kryera nga DRT Korç dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Korçë në datën 27.04.2015 me kërkesë padinë me objek i këtij shqyrtimi gjyqësor.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë në përfundim të gjyqimit të çështjes me vendimin Nr. 470, datë 30.09.2015 ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paditësit shoqërisë "Pacili" sh.p.k.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 470, datë 30.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Gjatë hetimit gjyqësor u provua se Njoftim Vlerësimi Tatimor me nr 5653, datë 17.11.2014 ka dalë nga DRT Korçë në adresë të shoqërisë paditëse, kjo e verifikueshme me librin e postës. Sipas informacionit nga Filiali i Postës Korçë është konfirmuar se objekti i mësipërm ka humbur dhe nuk i është dorëzuar personit të cilit i është adresuar. Gjatë gjykimit u pretendua se u morr dijeni mbi njoftimin e vlerësimit tatimor nga pala paditëse në datën 16.01.2015. Gjatë gjykimit nuk u provua kurrë se njoftim vlerësimi është dorëzuar me postë.
2. Gjkata ka vlerësuar se nuk mund të prezumohen efektet e nenit 106 të ligjit 9920 si dhe ato të pikave 23.2 dhe 69.4 të Udhëzimit nr 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" për të konsideruar se njoftimi për subjektin quhet i mare nga dita e 7-të pas datës së dërgimit nga DRT dhe mosmbëritja e aktit nuk mund të jetë në përgjegjësinë e tatimpaguesit përse kohë pranohet nga autoriteti që shpërndan aktet se nuk i është dorëzuar asnjëherë subjektit, pasi është humbur.
3. Gjkata ka vlerësuar se ankimi i subjektit vlerësohet i paraqitur brenda afatit 30 ditor nga marja dijeni dhe në kushtet kur vlerësohet i ezauruar rruga administrative e ankimit, në kuptim të nenit 106 e vijues të ligjit 9920 datë 19.05.2015 si dhe nenit 16 të ligjit 49/2012, vlerësohet se gjykata ka juridiksion për gjykimin e padisë me objekt shfuqizim akti administrativ. Gjkata ka mbështetur arsyetimin e saj dhe tek konkluzionet dhe arsyetimet e Vendimit Unifikues nr 3/2008.
4. Gjkata në referim të nenit 122 të ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimor në RSH", në lidhje me kundravajtjet administrative të shkaktuara nga mospërdorimi i pajisjeve fiskale, si dhe në referim të të dhënave të aktit pjesë e dosjes, gjykata ka vlerësuar se subjekti ka konsumuar kundravajtjen administrative për shkak të mos vendosjes së pajisjes fiskale në distributorin e gazit të lëngshëm.
5. Por gjykata ka vlerësuar se organet tatimore kanë vepruar në mënyrë të gabuar përse i përket masës së vendosjes së gjobës. Sikurse u provua gjatë gjykimit paditësit nuk i janë konstatuar më parë kundravajtje administrative në pikën e Kapshticës, ku ushtron aktivitetin. Por pretendimi i palës së paditur se ky subjekt është penalizuar dhe më parë me gjobë në masën 100 000 lekë u verifikuar se ky dënim ishte në pikën e karburanti Kapshtic-Bilisht (adresa dytësore mbajtur me process – verbal të datës 21.02.2014).
6. Gjkata duke arsyetuar mbi rrethanat faktike dhe përcaktimin e neni 122 pika 1, germa a) nënndarja ii) të ligjit 9920/2008 , ku ka klasifikuar shkeljen pala e paditur, konstatohet se kjo dispozitë i referohet rastit kur subjekti është konstatuar i papajisur me pajisje fiskale dhe megjithëse ndaj tij është zbatuar saknsioni prej 100 000 lekë sipas nënndarjes i) pas konstatimit për herë të parë, nga kontrolli i dyte rezulton se përsëri subjekti nuk ka instaluar pajisjen fiskale për të njejtin objekt tregëtimi, megjithë afatin tjetër të vendosjes prej 10 ditë.
7. Në rastin në gjykim kontrolli i palës së paditur në pikën e tregëtimit kur është mbajtur akti i konstatimit datë 24.08.2014 përfaqëson një kontroll për herë të parë dhe nuk rezulton që të ketë konstatim të mëparshëm ku paditësit ti jete lënë afat vendosje dhe ai të mos ketë instaluar pajisjen fiskale dhe as nuk është penalizuar më parë për mosinstalim pajisje fiskal në ndonjë nga distributorët e kësaj pike.

8. Në këtë aspekt çmohet se ndodhemi para zbatimit të gabuar të ligjit lidhur me identifikimin e kundravajtjes së kryer, me pasoja të drejtperdrejta pasurore për subjektin tatimpagues
9. Gjykata e ka vlerësuar se "Njoftim Vlerësimit" si një akt pjesërisht relativisht të pavlefshëm në kuptim të nenit 118 të K.Pr.Administrative, vetëm për masën e gjobës i cili duhet të anulohet për këtë pjesë dhe duhet të ngelet në fuqi masa prej 100 000 lekë.
10. Gjykata konkludon se me të drejtë nga paditësi kërkohet shfuqizimi i "Njoftim vlerësimit" të detyrimit tatimor pasi kemi të bëjmë me një akt pjesërisht të pathemelt, pra dhe pjesërisht të paligjshëm, për shkak se organet administrative që e kanë nxjerë atë nuk e kanë vlerësuar si duhet faktike që legjislacioni tatimor e kërkon si kusht për penalizimin e subjektit, por kanë konkluduar apriori se është kryer shkelja administrative sipas neni 122 të ligjit nr.9920.

Në këto rethana Gjykata Administrative e Apelit i shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike, ankimin e paraqitur nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, si dhe aktet e dosjes objekt gjykimi në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, objekt ankimi, të akteve të dosjes, si dhe në referim të dispozitave të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 470, datë 30.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë është marrë në përputhje me përcaktimet e ligjit procedural.

Megjithatë ky vendim është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit material që është i zbatueshëm në rastin konkret, e si i tillë ky vendim duhet të ndryshohet dhe kërkesë padia duhet të rëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova.

Rezulton se paditësi-shoqëria tregtare "Paceli" sh.p.k, ka goditur gjyqësisht njoftim vlerësimit tatimor nr. 5653, datë 17.11.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë, nëpërmjet të cilit përcaktohet detyrimi tatimor "gjobë" në masën 500,000. Nga aktet e depozituara në dosje, parashtrimet e palëve ndërgjyqëse gjatë gjykimit në shkallë të parë, rezulton se jemi në kushtet e kryerjes së kundravajtjes administrative, për shkak të mungesës së kasës fiskale në një nga depozitat e gazit të lëngshëm, të ndodhur në pikën e karburandit-Kapshticë, një nga pikat ku shoqëria "Paceli" sh.p.k ushtron aktivitetin e tij.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë, ka parashtruar në ankimin e saj se "Gjykata ka vlerësuar drejtë kur ka konstatuar kryerjen e kundravajtjes administrative nga ana e palës paditëse sipas nenit 122 të ligjit nr.9920, por gjykata ka keq interpretuar ligjin e posaçëm dhe gjëndjen e faktit të konstatuar në lidhje me aplikimin e masës së dënimit".

Gjykata Administrative e Apelit çmon se ky pretendim i palës së paditur është i bazuar në ligj dhe në prova e si i tillë duhet të pranohet.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar kryerjen e kundravajtjes administrative sipas përcaktimit të dispozitave të nenit 55 të ligjit 9920, në të cilën përcaktohet:

Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale dhe për vendosjen e sistemeve të monitorimit të qarkullimit.

1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet

përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

Në rastin konkret Gjykata Administrative e Apelit çmon se pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë ka bërë një vlerësim të detyrimit tatimor/ kundravajtje administrative të tatimpaguesit-palë paditëse referuar legjislacionit përkatës të zbatueshëm dhe sipas konstatimeve të kryera nga ana e palës paditëse në pikën e karburantit ku shoqëria ushtron aktivitet tregtar.

Sipas të dhënave të Aktit të Konstatimit datë 24.08.2014, rezulton se grupi i inspektimit ka konstatuar që në një nga adresat ku subjekti ushtron aktivitetin, rruga Kapshticë Korçë, tatim paguesi nuk ka pajisur me kasë fiskale një nga depozitat e gazit të lëngshëm, si rrjedhojë e kësaj kundravajtje është penalizuar me gjobë në masën 500.000 lekë.

Gjykata e Shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka vlerësuar se: kemi të bëjmë me një akt pjesërisht të pathemeltë, pra dhe pjesërisht të paligjshëm, për shkak se organet administrative që e kanë nxjerë atë nuk e kanë vlerësuar si duhet situatën faktike që legjislacioni tatimor e kërkon si kusht për penalizimin e subjektit.

Në referim të nenit 122, të ligjit nr 9920/2008, "Për Procedurat Tatimore" në RSH, si dhe Udhëzimi nr 24/2008 dalë në zbatim të ligjit 9920/2008 Per procedurat taimore në RSH. përcaktohet se:

Kundravajtjet administrative lidhur me përdorimin e pajisjeve fiskale dënohen bazuar në dispozitat që vijon: 122.1 Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

a) nuk instalon pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë:

i) herën e parë të konstatimit të mos instalimit të pajisjes fiskale, për të cilën është përcaktuar një afat vendosjeje deri në 10 ditë pune, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ii) herën e dytë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, pas mosrespektimit të afatit të parë 10-ditor dhe kur për këtë pajisje është përcaktuar një afat vendosjeje tjetër deri në 10 ditë, pas vendosjes së gjobës së parë, sipas nënndarjes "i" të shkronjës "a" të kësaj pike, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Referuar akteve të dosjes dhe pretendimeve të palës së paditur, si dhe parashtrimeve të paraqitura në ankim, rezulton se ndaj shoqërisë "Paceli" sh.p.k është konstatuar kundravajtja administrative, gjobë e mëparshme për mungesë të vendosjes së kasës fiskale, në një adresë tjetër ku shoqëria ushtron aktivitet. Nga të dhënat e sistemit rezulton se masa e gjobës 100,000 lekë është paguar nga paditësi, dhe rezulton të ketë përshkrimin "Dënim për mospajisjet me pajisje fiskale, për herë të parë".

Në këto rrethana gjykata çmon se pretendimi i palës së paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë është i bazuar në ligj e në prova dhe si i tillë i pranueshëm.

Gjykata Administrative çmon se konstatimi i mungesës së kasës fiskale për një nga impjantet e gazit të lëngshëm në pikën Kapshticë Korçë, është kundravajtje e kryer sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 122 të ligjit 9920/2008, dhe kjo kundravajtje rezulton të jetë në kushtet e një rasti të përsëritur për herë të dytë. Sikurse u provua gjatë gjykimit në shkallë të parë shoqëria është penalizuar dhe më parë për të njëjtën shkelje, për rastin e mungesës së pajisjes fiskale, në masën 100,000lekë.

Gjykata Administrative e Apelit në referim të ligjit nr. 9920/2008 si dhe udhëzimit të dalë në zbatim të tij nr. 24/2008, DRT Korçë ka aplikuar vendosjen e gjobës sipas përcaktimit të nenit 55, dhe 122, pika a) nëndarja ii). Gjykata e apelit çmon se autoritetet tatimore, gjatë veprimeve të tyre në ushtrim të funksioneve dhe detyrave i referohen subjektit të regjistruar për ushtrimin e një

aktiviteti të caktuar me termin "person i tatueshëm" i cili përfaqësohet në sistemin tatimor me një numër unikues identifikimi unik (NIPT).

Në referencë të nenit 40.4 dhe udhëzimi 24/2008, Detyrimi i personit të tatueshëm për rregjistrim, përcaktohet se:

Çdo person i tatueshëm, në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, pajiset me Certifikatën e Regjistrimit e cila përmban edhe numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT). Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm është unik. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikate regjistrimi për çdo adresë, e cila ka të njëjtin NIPT unik.

Për sa më lartë gjykata çmon se paditësi-tatimpaguesi "Paceli" sh.p.k, është një shoqërie e regjistruar sipas përcaktimeve ligjore të ligjit, për shoqëritë tregtare dhe është i regjistruar në sistemin fiskal duke u pajisur me një numër NIPT, kjo shoqëri rezulton të ushtrojë aktivitetin në disa adresa të ndryshme për të cilat është i pajisur me NIPT sekondar. Konstatimi i kundravajtjeve në rastin konkret mungesa e pajisjes fiskale, në vendndodhjet ku ai ushtron aktivitet, rezulton të jetë kundravajtje për shoqërinë "Paceli" sh.p.k, për herë të dytë, për shkak se nuk mund të bëhet kategorizimi i kundravajtjeve për adresat ku zhvillohet aktiviteti, por kundravajtja individualizohet për subjekt. Kundravajtja administrative është e lidhur me subjektin që e kryen dhe jo me vendndodhjen e aktivitetit apo të vendit ku ofrohet malli apo shërbimi. Paditësi rezultoi të ketë kryer kundravajtjen administrative në datën 21.02.2014 si dhe kundravajtjen administrative në datën 24.08.2014 (objekt i këtij gjykimi). Në këto kushte DRT Korçë ka aplikuar masën e dënimit në vlerën 500,000 lekë, për herën e dytë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale.

Sa u përshkrua më sipër, gjykata i gjen të themelta pretendimet e ngritura në ankim nga pala e paditur e për rrjedhojë i çmon ato të pranueshme.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë nr. 470, datë 30.09.2015, është i gabuar dhe i pabazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë referuara përcaktimeve të nenit 50 gërma "c" të ligjit Nr. 49/2012, duhet të ndryshohet dhe padia duhet të rëzohet si i pa bazuar në ligj dhe në prova.

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "c" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI :

1. Ndryshim e vendimit nr. 470, datë 30.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.
2. Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj.
3. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
4. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 10.12.2015

GJYQTAR

Rilinda SELIMI

d.v

GJYQTAR

Altina NASUFI

d.v

GJYQTAR

Kastriot SELITA

d.v

Vertetohet njesia me origjinalin